Këto dalje janë kombinuar në mënyrë që shpërndarja e ngarkesës të jetë e njëtrajtshme në të gjitha daljet.

Në figurat e mëposhtme janë paraqitur topologjitë e propozuara për daljet ku secila ngjyrë karakterizon seksionin e linjës.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 30 prej 45
		Versioni	1.0




Figura 31. Topologjia e propozuar e daljes Turiquevci





Figura 32. Topologjia e propozuar e daljes Likovci

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 31 prej 45
		Versioni	1.0




Figura 33. Topologjia e propozuar e daljes Qirezi

Në tabelën e mëposhtme është dhënë analiza energjetike e daljeve para dhe pas investimit.


Tabela 11. Të dhënat para dhe pas investimit - Daljet Turiqevci, Likovci dhe Qirezi 20 [kV]

Daljet TM		Ngarkesa [MW]	Nr. i Konsumatorëve	Nr. i TR	Ngarkesa Max. e Linjës (%)	Humbjet [MWh]	Tensioni min. [p.u]
Turiqevci	Para	3.04	1,986	52	128.82	1,465.92	0.750
Likovci		3.18	2,026	51	81.09	1,288.79	0.860
Qirezi		2.82	1,747	41	115.74	1,507.50	0.797
Dalja 1 (Turiqevci)	Pas	1.96	1,361	35	33.30	513.04	0.956
Dalja 3 (Likovci)		2.77	1,613	42	37.44	594.06	0.971
Dalja 4 (Qirezi)		2.08	1,307	30	33.28	376.09	0.941

NS Skenderaji 110/10(20) [kV] ka dy TR 110/10(20) [kV], me fuqi 31.5 + 40 [MVA]. Është planifikuar që TR 1 të furnizoj daljet të cilat do të vazhdojnë të operojnë në nivelin 10 [kV], kurse TR 2 të furnizoj daljet të cilat do të kalojnë në nivelin 20 [kV]. Këto dalje janë: Qirezi, Likovci, Llausha, Turiqevci dhe Runiku. Runiku veçse operon në nivelin 20 [kV] me anë të transformatorit ngritës 4 [MVA], i cili do të demolohet dhe do të shfrytëzohet diku tjetër.

Në mes të zbarrave 10 [kV] dhe 20 [kV], do të vendosen TR 3 x 8 [MVA], të cilët do të shërbejnë për ruajtjen e kriterit N-1.

Në figurën më poshtë është dhënë skema njëpolëshe e NS 110/10(20) [kV] Skenderaji pas vendosjes së mes-transformatorëve 10/20 [kV].

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 32 prej 45
		Versioni	1.0




Figura 34. Skema njëpolare e NS Skenderaj 110/10(20) [kV] pas investimeve

Dalja Qytet e Fshatra

Qytet e Fshatra është një ndër daljet më problematike të Kosovës. Dalja karakterizohet me ngarkesë të madhe, humbje teknike të madhe [MWh], rënie të tensionit dhe numër të madh të ndërprerjeve. Përveq kësaj dalja është shumë e gjatë dhe e përbërë nga degë të shpërndara dhe fyte të ngushta të cilat ndikojnë në tensionin e konsumatorit fundor.



Figura 35. Topologjia e propozuar e daljes Qytet e fshatra


	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 33 prej 45
		Versioni	1.0

Tabela 12. Të dhënat para dhe pas investimit - Dalja Qytet e Fshatra 20 [kV]

Dalja TM		Ngarkesa [MW]	Nr. i Konsumatorëve	Nr. i TR	Ngarkesa Max. e Linjës (%)	Humbjet [MWh]	Tensioni min. [p.u]
Qytet e Fshatra	Para	5.76	2,759	34	239.58	1,671.14	0.784
	Pas	5.76	2,759	34	46.05	419.76	0.989

Dalja Barani

Dalja Barani karakterizohet me ngarkesë të madhe të linjave, humbje të mëdha të energjisë, nr.të madh të ndërprerjeve dhe rënie të larta të tensionit.

Në figurën e mëposhtme është paraqitur topologjia e propozuar e daljes ku secila ngjyrë karakterizon seksionin e linjës.




Figura 36. Topologjia e propozuar e daljes Barani

Në tabelën e mëposhtme është dhënë analiza energjetike e daljes para dhe pas investimit.

Tabela 13. Të dhënat para dhe pas investimit - Dalja Barani 20 [kV]

Dalja TM		Ngarkesa [MW]	Nr. i Konsumatorëve	Nr. i TR	Ngarkesa Max. e Linjës (%)	Humbjet [MWh]	Tensioni min. [p.u]
Barani	Para	5.68	2,385	56	200.00	2,031.00	0.670
	Pas	5.68	2,385	58	70.69	1,128.51	0.920

Për konvertimin e kësaj dalje në 20 [kV] do të vendoset një transformator ngritës 10/20 [kV] me fuqi të instaluar 8 [MVA] në NS 110/10 [kV] Deçani.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 34 prej 45
		Versioni	1.0

Dalja Rugova

Rugova është një dalje shumë e gjatë e cila shtrihet në territor malor, ku si pasojë ka edhe ndërprerje të shumta dhe që zgjasin me orë të tëra. Distancat e mëdha ndikojnë që vlera e tensionit deri te konsumatori fundor të jetë nën standardet e lejuara.



Figura 37. Topologjia e propozuar e daljes Rugova


Tabela 14. Të dhënat para dhe pas investimit - Dalja Rugova 20 [kV]

Dalja TM		Ngarkesa [MW]	Nr. i Konsumatorëve	Nr. i TR	Ngarkesa Max. e Linjës (%)	Humbjet [MWh]	Tensioni min. [p.u]
Rugova	Para	1.53	993	37	79.12	359.32	0.840
	Pas	1.53	993	37	27.06	308.74	0.945

2.3 Projektet në nivelin 10 [kV]

Projektet e planifikuara për investim në nivelin 10 [kV] janë dizajnuar për të mundësuar furnizim të sigurt dhe të pandërprerë me energji për konsumatorët, për të siguruar funksionimin e rrjetit në përputhje me rregullat, kodet dhe ligjet në fuqi. Objektivat kryesore të këtyre projekteve i adresohen çështjeve sipas prioriteteve të mëposhtme:

- Rritja e sigurisë, efikasitetit, besueshmërisë dhe cilësisë teknike të rrjetit të shpërndarjes
- Rritja e cilësisë së furnizimit me energji elektrike (treguesit e vazhdimësisë së furnizimit, cilësisë së tensionit, etj.)
- Përshtatja e kapaciteteve bartëse dhe transformuese në raport me rritjen e ngarkesës dhe konsumit të energjisë

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 35 prej 45
		Versioni	1.0

- Zvogëlimi i humbjeve teknike
- Rehabilitimi dhe modernizimi i stabilimenteve dhe rrjetit ekzistues
- Pajtueshmëria me standardet e operimeve dhe performancës

Pasi që kriza energjetike që filloi në vitin 2021 shkaktoi vonesa në implementimin e projekteve, të gjitha projektet në nivelin 10 [kV] në të cilat do të investohet gjatë këtij viti janë projekte të bartura nga viti 2021.

Hoqa e Qytetit

Hoqa e Qytetit karakterizohet me nr. të madh të ndërprerjeve dhe problemeve me rëniet e tensionit, andaj dhe është planifikuar të investohet në këtë dalje.

Në figurën e mëposhtme është paraqitur topologjia e propozuar e daljes ku secila ngjyrë karakterizon seksionin e linjës.




Figura 38. Topologjia e propozuar e daljes Hoqa e Qytetit

Në tabelën e mëposhtme është dhënë analiza energjetike e daljes para dhe pas investimit.

Tabela 15. Të dhënat para dhe pas investimit - Dalja Hoqa e Qytetit 10 [kV]

Dalja TM		Ngarkesa [MW]	Nr. i Konsumatorëve	Nr. i TR	Ngarkesa Max. e Linjës (%)	Humbjet [MWh]	Tensioni min. [p.u]
Hoqa e Qytetit	Para	2.45	1,271	15	86.58	248.20	0.896
	Pas	2.45	1,271	15	42.93	145.44	0.974

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 36 prej 45
		Versioni	1.0

Në tabelën më poshtë është dhënë përfitimi në humbje nga projektet në nivelin 10 [kV] dhe projektet për kalim në 20 [kV].

2.4 Projektet për shtimin e kapacitetit transformues dhe revitalizimin e nënstacioneve 35/10(20) [kV]

OSSH përgjatë periudhës 10 vjeçare 2023-2032 parasheh që të eliminoj të gjitha kthinat e tensionit të mesëm 35 [kV], 10 [kV] apo 6 [kV] që janë të tipit të hapur, pra të gjitha nënstacionet që tashmë konsiderohen të vjetra dhe që kanë një kohë të gjatë në operim.

Njëri prej disa nënstacioneve se ku janë të vendosura kthinat SIEMENS është **NS 110/10 [kV Mitrovica]**. Ky nënstacion nuk ka ndonjë kthinë rezervë e cila do të mund të përdorej në rast të ndonjë defekti apo avarie në kthinat ekzistuese të energjizuara, ku do të bëhet ndërrimi i kthinave gjatë vitit 2023.

Një investim i tillë bazohet në faktin se kthinat ekzistuese kanë përfunduar ciklin e prodhimit të tyre dhe duke e ditur që në rast të ndonjë avarie apo defekti në kthinat ekzistuese të NS 110/10 [kV] Mitrovica nuk do të kishte një zgjidhje të menjëhershme për të evituar dëmet që do të mund të paraqiteshin. Është e rëndësishme të përmendet që pas ndërrimit të kthinave, kthinat SIEMENS do të përdoren si kthina rezervë për nënstacionet tjera ku është i instaluar ky lloj i kthinës, si:

- NS Podujeva 220/35/10 [kV]
- NS Prishtina 5 110/10 [kV]
- NS Vushtrria 2 110/10 [kV]
- NS Peja 2 110/10 [kV]
- NS Prizreni 1 110/35/10 [kV] – Ana 10 [kV]


Nënstacione të tjera ku planifikohet të bëhet ndërrimi i kthinave gjatë vitit 2023 është:

- NS 10 [kV] Gjakova II

Në tabelën më poshtë është dhënë nr. i transformatorëve të fuqisë dhe kthinave të reja në nënstacionet 35/10(20) [kV].

Tabela 16. Projektet në Nënstacione

Projekti	Info	Sasia
Ndërrimi dhe instalimi i TR-ve të fuqisë	8 [MVA]	1
	STEP UP 8 [MVA]	5
Kthinat e reja në nënstacione		61
Totali		67

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 37 prej 45
		Versioni	1.0

Vendosja e TR-ve të fuqisë do të realizohet te projektet si më poshtë:

- TR 8 [MVA] 35/10(20) [kV] do të shtohet në NS i ri 35/10 [kV] Kaçaniku II
- TR 8 [MVA] 10/20 [kV] do të vendoset në NS 110/10 [kV] Deçani për konvertimin në 20 [kV] të daljes Barani
- TR 8 [MVA] 10/20 [kV] do të vendoset në NS 110/10 [kV] Gjakova 2 për konvertimin në 20 [kV] të daljeve Ura Terezive dhe Bistazhini
- TR 3x8 [MVA] 10/20 [kV] do të vendosen në NS 110/10 [kV] Skenderaj për konvertimin në 20 [kV] të daljeve Llausha, Turiqevci, Likovci dhe Qirezi.

3. PROJEKTET NË TENSION TË ULËT

3.1 Projektet për përforcim dhe zgjerim

Në gjithë rrjetin e OSSH-së, ka pjesë të rrjetit të cilat kërkojnë investime për shkak të gjendjes së keqe. Në mënyrë që të investohet në zonat më kritike, analiza është bërë duke marrë parasysh kriteret e prioriteteve për zgjedhjen e projekteve.

Qëllimet kryesore të projekteve për përforcim të rrjetit janë:

- Përmirësimi i cilësisë së furnizimit me energji elektrike dhe zvogëlimi i humbjeve teknike, dhe
- Qasje më e lehtë në pikën matëse dhe reduktim i humbjeve jo-teknike

Investimet e bëra në projektet e tensionit të ulët përfshijnë:

- Ndërtimi i transformatorëve distributiv të rinj 10(20)/0.4 [kV] në një regjion apo më shumë ku vlera e humbjeve teknike dhe jo-teknike në rrjetin e tensionit të ulët është shumë e madhe
- Rehabilitimi i rrjetit ekzistues 10 [kV] deri te transformatori i ri
- Rehabilitimi i rrjetit ekzistues ose ndërtimi i rrjetit të ri në TU
- Montimi i kutive (kuadrove) nëpër shtylla nëse është rrjet ajror dhe nëpër kuadro të tokës nëse është rrjet nëntokësor
- Vendosja, gjegjësisht bartja e njehsorëve prej shtëpive për t'u vendosur nëpër kuadrot e montuar në shtylla
- Ndërrimi i njehsorëve mekanik me ata 'të mençur', dhe
- Montimi i PLC-ve


	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 38 prej 45
		Versioni	1.0

Tabela 87. Të dhënat për projektet për përforcim dhe zgjerim në vitin 2023

Distrikti	Kostoja [Euro]	Numri i Projekteve	Numri i Konsumatorëve	Përfitimi nga Humbjet [MWh]	Përfitimi nga Humbjet [Euro]
Prishtina	2,964,186	102	12,100	21,670	2,505,051
Prizren	360,569	11	854	593	68,528
Mitrovica	2,539,322	72	4,305	8,663	1,001,496
Ferizaj	-	-	-	-	-
Peja	415,098	11	870	1,495	172,809
Gjilani	-	-	-	-	-
Gjakova	745,973	26	1,394	2,346	271,142
TOTAL	7,025,149	222	19,523	34,767	4,019,026

Përfitimet e pritshme përfshijnë: furnizim të qëndrueshëm të energjisë, përmirësimin e kualitetit të tensionit, reduktimin e humbjeve teknike dhe jo-teknike dhe përmirësimin e topologjisë së rrjetit.


4. PROJEKTET NË SMART GRID

Fokusi i aktiviteteve të operatorëve të ndryshëm në mbarë botën është automatizimi i sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, duke përdorur avancimet dhe zhvillimet e fundit në fushën e teknologjisë dhe sistemit të komunikimit të të dhënave.

OSSH viteve të fundit ka qenë mjaft i fokusuar në digjitalizimin e rrjetit elektrik duke zhvilluar sisteme të ndryshme të cilat mundësojnë monitorimin dhe kontrollimin e rrjetit elektrik.

Me zhvillimin e sistemeve digjitale të programueshme, mund të kombinohen të gjitha funksionet mbikëqyrëse, funksionet e kontrollit dhe funksionet mbrojtëse në një sistem të vetëm gjë që më pas e bën edhe më të lehtë përdorimin e tyre. Një sistem i tillë i integruar së fundi nga OSSH është edhe sistemi SCADA.

Menaxhimi i sistemit elektroenergjetik shpërndarës, mirëmbajtja e tij, kontrollimi dhe monitorimi janë sfidat kryesore të kompanive të cilat operojnë me këtë sistem. Çdo herë në nënstacionet elektrike janë të nevojshme të bëhen matje, mbikëqyrje, kontrollat, operime dhe funksione mbrojtëse me qëllim të përmirësimit dhe rritjes së besueshmërisë së furnizimit me energji elektrike. Integrimi i sistemeve të automatizimit, ndryshimet në rrjetin ekzistues elektrik, instalimi i pajisjeve të reja, përdorimi i makinerive janë vetëm disa prej investimeve të parapara në vitet e ardhshme.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 39 prej 45
		Versioni	1.0

Në tabelën 18 janë paraqitur projektet të cilat do të realizohen gjatë vitit 2023:

Tabela 9. Projektet për Smart Grid


Projekti	Sasia
Instalimi i SCADA-ës në SSh	63
Instalimi i FID-ave	7
Instalimi i Autoreclosers	1
Instalimi i rregullatorëve të tensionit	1
Instalimi i mbushësve të veturave elektrike	1
SCADA Qendra e kontrollit emergjent	1
Aplikacione për kalkulime për rele	1
Dronat	7
Totali	82

Instalimi i sistemit SCADA në stabilimente: Njëra ndër synimet kryesore të OSSH-së është që të rrisë besueshmërinë dhe të zvogëloj kohën e ndërprerjeve sa i përket furnizimit me energji elektrike. Njëra ndër mënyrat e shumta për të arritur një objektivë të tillë, është instalimi i sistemit SCADA në stabilimente apo nënstacione sekondare.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes pas realizimit të monitorimit dhe kontrollit të rrjetit në nivelin e tensionit të mesëm, ka vazhduar me zbatimin e këtij procesi në nivel të tensionit të ulët. Në rrjetin e shpërndarjes ka një numër të madh të stabilimenteve shpërndarëse 10(20)/0.4 [kV] të vendosura në lokacione të ndryshme në të cilat mund të instalohet sistemi SCADA.

Instalimi i Detektorëve Tregues të Defekteve (FID): Duke qenë se sistemi elektrik i shpërndarjes është një sistem më i ndërlikuar dhe duke e ditur se elementet e këtij sistemi janë të shpërndara nëpër shumë pika qofshin ato të hapura apo të mbyllura mund të themi se sistemi i shpërndarjes është vazhdimisht i ekspozuar ndaj dukurive të defekteve për arsye të ndryshme, si goditja e rrufesë, dështimi i pajisjeve, kushtet e këqija atmosferike etj.

Të gjitha dukuritë të cilat shkaktojnë prishje apo dështime të rrjetit të shpërndarjes ndikojnë në besueshmërinë e sistemit dhe rezultojnë në riparime ndonjëherë të shtrenjta, humbje të produktivitetit dhe humbje të energjisë për klientët. Meqenëse defekti është i paparashikueshëm, kërkohet një vendndodhje dhe izolim i shpejtë i defektit për të minimizuar ndikimin e këtyre defekteve në sistemet e shpërndarjes. Në shumicën e këtyre prishjeve janë ekipet e rrjetit dhe mirëmbajtjes ato që kanë punën më të madhe për

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 40 prej 45
		Versioni	1.0

t'i eliminuar këto prishje apo defekte dhe për të rikthyer më pas furnizimin me energji elektrike për konsumatorë. Mirëpo tendenca e OSSH-së është që të përdorë pajisje dhe metoda të ndryshme për të lokalizuar defektet e ndryshme që ndodhin në rrjet. Një nga këto pajisje janë edhe detektorët tregues të prishjeve (defekteve).

OSSH së fundi ka instaluar Detektorin Tregues të Defekteve (FID), në linjën ajrore 35 [kV] Prizren 1 - Zhur. Pra, FID-i i parë është instaluar gjatë vitit 2021 dhe është e rëndësishme të përmendet se ky FID mund të monitorohet nga sistemi ekzistues SCADA.

Gjatë vitit 2023 do të instalohen 7 FID.

Instalimi i rimbyllësve automatik: Rimbyllësi automatik është një lloj pajisje komutuese inteligjente e përdorur në automatizimin e rrjetit të shpërndarjes. Mund të zbulojë rrymën e defektit (lidhjeve të shkurta), të shkyç qarkun brenda një kohe të caktuar dhe të kryejë një numër të caktuar rimbylljesh.


Në vitin 2023, OSSH planifikon të instalojë rimbyllësin (kyçësin) e parë në rrjetin e shpërndarjes. Ky rimbyllës automatik do të instalohet në një pikë të LP 10(20) [kV] që përballet me defekte (avari) të shpeshta dhe që shtrihet në zona jo të përshtatshme.

Kjo pajisje lejon që furnizimi të rikthehet automatikisht, pas vetëm një ose dy luhatjesh. Rimbyllësi automatik që do të instalohet do t'i kursejë kompanisë kohë dhe shpenzime të konsiderueshme.

Instalimi i rregullatorëve të tensionit: Tensioni i duhur, disponueshmëria e energjisë sipas kërkesës dhe besueshmëria janë disa nga kërkesat kryesore që duhen plotësuar për të pasur një sistem të mirë shpërndarjeje.

Një nga kërkesat më të rëndësishme të një sistemi shpërndarës është që ndryshimet e tensionit duhet të jenë sa më të ulëta që të jetë e mundur. Këto ndryshime të tensionit vijnë si pasojë e ndryshimit të ngarkesës në sistem. Me qëllim të shmangies së rënieve të tensionit dhe me qëllim të sigurimit që ndryshimet e tensionit në терминалет e konsumatorëve të jenë brenda kufijve të lejuar, OSSH planifikon që gjatë vitit 2023 të bëjë instalimin e rregullatorit të parë të tensionit në daljet 10(20) [kV].

Instalimi i karikuesëve (mbushësve) të automjeteve elektrike: Duke pasur parasysh zhvillimin e vullshëm të automjeteve elektrike, OSSH planifikon të instalojë sistemin e karikuesit AC dhe DC në Prishtinë gjatë vitit 2023.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 41 prej 45
		Versioni	1.0

Qendra Emergjente e Kontrollit - SCADA: Qendra Kryesore e Kontrollit (MCC) e sistemit SCADA të cilin e përdor OSSh është një pikë shumë kritike ndaj është e nevojshme të sigurohet një Qendër e Kontrollit Emergjent si rezervë. Roli i ECC është të koordinojë reagimin gjatë një incidenti të madh ose emergjence. Qendra e Kontrollit të Emergjencave që është planifikuar të integrohet do të luajë një rol kritik në çdo fazë të menaxhimit të emergjencave, duke qenë pika kryesore për të gjithë koordinimin gjatë një incidenti. Kjo qendër e kontrollit parashihet të ndërtohet gjatë vitit 2023 dhe do të përfshij:

- Sigurimin e hapësirës dhe elementeve të brendshme (invertari)
- Dizajnimin e Qendrës Emergjente
- Instalimin e serverëve dhe pajisjeve për komunikim
- Instalimin e UPS-it
- Instalimin e stacioneve të punës
- Inxhinieringun për funksionimin e saj


Softueri për llogaritje të releve: OSSh përdor aplikacione apo softuer të ndryshëm të cilët mundësojnë kryerjen e aktiviteteve të përditshme, të cilët poashtu ndihmojnë në llogaritje të ndryshme. Mirëpo si mungesë e mëhershme në kuadër të softuerëve të shumtë të cilët përdoren brenda OSSH-së ka qenë softueri për llogaritje të parametrave të releve dhe koordinimin e tyre.

Qëllimi parësor i përdorimit të këtij softueri do të jetë vendosja e të gjitha releve të sistemit të shpërndarjes në këtë softuer me ç’rast më pas do të mund të bëheshin llogaritje, parametrizime dhe simulime të ndryshme të cilat do të ndihmonin jashtëzakonisht shumë në analizat e ndryshme të rrjetit elektrik sa i përket mbrojtjes së sistemit të shpërndarjes dhe dimensionimit të elementeve të ndryshme të reja që do të instaloheshin në teren gjatë viteve në vijim.

Softueri do të shërbej për optimizimin, kontrollin, parashikimin, simulimin dhe menaxhimin e skenarive të ndryshëm që do të projektohen për analiza të ndryshme.

Përdorimi i dronëve: Me qëllimin që të arrihet deri tek mirëmbajtja e duhur e linjave ajrore OSSh dy vite më parë është pajisur me një pajisje dron e cila kryesisht është përdorur për inspektimin e linjave ajrore. Përdorimi i dronit u ka mundësuar ekipeve të rrjetit të inspektojnë strukturat e linjave ajrore përderisa linjat ishin të energjizuara. Ekipet nga përdorimi i këtij droni kanë përfituar nivel më të lartë të detajeve sa i përket gjendjes së linjave ajrore me ç’rast është bërë inspektimi dhe janë marrë masat e nevojshme për identifikimin e pikave të nxehta e sidomos masa për pastrimin e linjave shpërndarëse nga vegjetacioni.

Duke parë përparësitë e përdorimit të një droni në tërë rrjetin elektrik shpërndarës, atëherë OSSh planifikon që gjatë vitit 2023 të bëjë blerjen e 7 dronëve të tjerë. Shpërndarja e tyre do të bëhet e tillë që

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 42 prej 45
		Versioni	1.0

secili distrikt i Kosovës të jetë i pajisur me një pajisje të tillë e cila do të shërbente si ndihmesë shtesë për ekipet e rrejtimit-mirëmbajtjes për inspektimin e linjave ajrore.

Përdorimi i dronëve në inspektimin e sistemit shpërndarës sjell disa avantazhe si: rritja e sigurisë dhe zvogëlimi i rreziqeve për teknikët e mirëmbajtjes, rritja e saktësisë në mbledhjen e të dhënave të gjendjes së një asemi, efikasitet më i lartë, procese të përmirësuara të planifikimit për mirëmbajtje, kohë e reduktuar e riparimit në situata emergjente, akses në zonat e bllokuara nga uji apo pemët e rrëzuara etj.

5. PROJEKTET NË NJEHSORË

Që nga viti 2007 filloi vendosja e njehsorëve elektronik dhe deri tani pothuajse 85.1% të konsumatorëve iu janë zëvendësuar njehsori, megjithatë një tjetër 14.9% e konsumatorëve janë ende të furnizuar me njehsorë elektromekanik


Plani i OSSh për zëvendësimet e njehsorëve është që të përqendrohet kryesisht në zonat të cilat janë më të vështira për qasje, si:

- Zonat rurale, ku është vështirë të ketë qasje në konsumator,
- Zonat rurale / pyjore, ku janë të vendosur kryesisht konsumatorë të vegjël,
- Zonat, ku janë konsumatorët problematikë,
- Zonat, ku konsumimi është i lartë dhe
- Zonat, sipas kërkesave që do të shfaqen.

Në tabelën 19 janë dhënë projektet në njehsorë gjatë vitit 2023 dhe sasia e planifikuar për investim për njehsorë të mençur, indirekt, gjysëm indirekt dhe njehsorë elektronik të thjeshtë. Gjithashtu është planifikuar dhe projekt në upgrade-imin e pajisjeve testuese.

Tabela 10. Projektet në njehsorë për vitin 2023

Përshkrimi	Sasia
Njehsor të mençur	22,200
Njehsor indirekt	50
Njehsor gjysëm indirekt	1,000
Njehsor elektronik i thjeshtë	51,329
Upgrade i pajisjeve testuese lab	1
Total	74,580

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 43 prej 45
		Versioni	1.0

6. PROJEKTET NË LOGJISTIKË

Operimet e përditshme të operatorit të sistemit të shpërndarjes, kërkojnë përdorimin e vazhdueshëm të makinerive, si mjetet e transportit ashtu edhe makinat profesionale të rënda.

Në tabelën 20 janë dhënë projektet në makineri për vitin 2023.

Tabela 11. Projektet në Makineri për vitin 2023


Përshkrimi
Minivan
4x4 Pick-Up

Paralelisht me zhvillimin e vendit dhe sektorin e energjisë, OSSh do të vazhdojë me projektin e rinovimeve dhe ndërtimeve të reja sipas nevojave të kompanisë.

Në tabelën 21 janë dhënë projektet në ndërtesa për vitin 2023.

Tabela 21. Projektet në Ndërtesa për vitin 2023

Përshkrimi
Ndërtimi i Punëtorisë me Konstruksion Metalik për Ekipin e Elektro Inxhinieringut - Prishtinë (Graçanicë)
Rikonstruimi i Objektit së Elektro Inxhinieringut - Lulishte, Prishtinë
Laboratori Matës i Ri - Lipjan

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 44 prej 45
		Versioni	1.0


7. PROJEKTET NË IT

Sot, projektet e teknologjisë informatike janë investime me rëndësi të lartë për OSSH-në, të cilat përdoren në fushat e vazhdimësisë së biznesit (business continuity), efikasitetit, dhe komunikimit. Në përgjithësi janë klasifikuar si më poshtë:

Në tabelën 22 janë dhënë projektet në IT për vitin 2023.

Tabela 22. Projektet në IT për vitin 2023

Përshkrimi
Hardueri
Softueri
Siguria Kibernetike
Data Qendra
Rrjetet e TI
Siguria Fizike

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 45 prej 45
		Versioni	1.0

8. PËRFUNDIM

Siç është theksuar në pjesët e mëparshme, është shumë e rëndësishme të zhvillohet vazhdimisht rrjeti i shpërndarjes, veçanërisht në Kosovë, i cili ende nuk është në nivel të kënaqshëm. Këto investime janë të nevojshme për OSSh-në për të siguruar shërbime të qëndrueshme dhe cilësore.

Nevoja për rehabilitimin, zgjerimin, adaptimin dhe aplikimin e standardeve në asetet e sistemit të shpërndarjes është shumë e qartë. Për shkak të kushteve në terren që janë evidente dhe në përputhje me objektivat e rrjetit, nevoja për të orientuar investimet në nivelin e tensionit të ulët si projekte me prioritet të lartë, është e qartë; veçanërisht në fushën më problematike në të cilën ka nevojë për një zgjidhje emergjente dhe që ndikon në një numër më të madh të konsumatorëve. Përmirësimi i kapaciteteve të kufizuara në sistemet e mbingarkuara me tension të lartë dhe krijimi i kushteve për zhvillimin e rrjetit të tensionit të ulët konsiderohet si kriter bazë meqë plotëson kushtet teknike dhe ekonomike për planifikimin e rrjetit të shpërndarjes dhe siguron furnizim cilësor dhe të sigurtë për pjesën më të madhe të konsumatorëve. Si të tilla, këto projekte përfshihen në Planin Investiv 2023.

Projektet janë të fokusuara në rritjen e besueshmërisë duke zvogëluar ndërprerjet e energjisë elektrike për shkak të ngarkesës (duke përmirësuar SAIDI-n dhe SAIFI-n) në saje të plotësimit të kriterit N-1 dhe duke zvogëluar ngarkesat në daljet e mbingarkuara. Dizajni i ri i projekteve do të sigurojë që kualiteti i përgjithshëm i tensionit të përmirësohet gjithashtu. Përmirësimet në kualitetin e tensionit dhe zvogëlimin e ngarkesave në daljet e mbingarkuara, do të rezultojnë në zvogëlimin e humbjeve teknike.

Është e rëndësishme të theksohet se disa nga përfitimet e OSSh-së janë të pamatshme, por megjithatë ato ndikojnë në të gjithë konsumatorët e energjisë elektrike, duke përmirësuar shërbimet e shpërndarjes, rritjen e efikasitetit të fuqisë punëtore dhe cilësinë e furnizimit. Për më tepër, siç u tha më parë, disa nga projektet e parashikuara janë gjithashtu për shkak të kërkesave ligjore, siç janë zëvendësimet e njehsorëve, apo deri tek kërkesat e reja që rrjedhin nga ndryshimet në legjislacion (hapja e tregut). Zbatimi i këtyre projekteve do të mundësojë zhvillimin e vazhdueshëm të sektorit, do të krijojë kushte të favorshme për konsum të sigurtë, cilësor dhe efikas të energjisë elektrike.